

BALLINA / LAJME

Detaje të reja pse burri vrau gruan dhe fqinjin e tij në Vushtrri

February 17, 2017

February 17, 2017

Një burrë vrau fqinjin e tij dhe më pas e vrau edhe gruan, ngjarje kjo që ndodhi në fshatin Vernicë të Vushtrrisë, mbrëmjen e së enjtes.

Ndonëse ende nuk dihen arsyet që çuan në këtë akt makabër, GazetaExpress merr vesh se dorasi tashmë është arrestuar, ndërkaq është gjetur edhe arma më të cilën dyshohet se e kreu krimin.

Këtë e ka konfirmuar për Express, Avni Zahiti zëdhënës i Policisë së Kosovës për rajonin e Mitrovicës. Ai pranoi se viktima femër ishte gruaja e dorasit.

“Jemi ende në fazën fillestare për shkak se është një proces që di të zgjas, ajo çka deri tash është e njohur, është se dorasi ka kryer vrasje. E ka vrarë gruan e tij dhe një person tjetër për të cilin nuk e ka vrarë atë afër, por e ka vrarë në një tjetër lokacion në zonën e atij fshati”, sqaroi Zahiti për Express.

Ai tha se ende nuk dihen raportet se çfarë kanë qenë mes tyre, ndërsa dy kufomat janë në obduksion në mjekësinë ligjore./GazetaExpress/

PËRGJIGJU

Koment:

Emri:*

Email:*

Webfaqja:

☐ Ruaj emrin tim, postën elektronike dhe faqen e internetit në këtë shfletues për herën tjetër që komentoj.

Posto Komentin



THIRR KUR DUSH



+38343745845

+38343728800

MË TË FUNDIT



Zyrtari i Komunës së Vushtrrisë, ndërron jetë



2 vjeçarja nga Broboniqi ka rënë në Komë pas marrjes së...



Blerim Kuçi e lëshoi studion televizive, ironizon keq Imer Mushkolaj: E...



Shoferi i Melihate Tërmkollit dhe Tomë Gashi përleshën pas debatit në...



Eskalon debati: Tërmkolli i thotë Gashit “çuti”, ai ia kthen “zoti...